VENDIM
Nr. 7, datë 16.1.2020

MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", dhe VKM nr. 687, datë 22.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", nenit 15 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 5/3 prot., datë 13.1.2020, në lidhje me miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 12.12.2019 la në fuqi vendimin nr. 8, datë 17.1.2019 "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2019", deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR.

- Në vijim të publikimit të raportit vjetor të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të Bursës Hungareze të Energjisë për vitin 2019 dhe kursit të këmbimit lekë/EUR të Bankës së Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 201, datë 12.12.2019, plotësohen kushtet për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi".

- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) është marrë çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2019, i cili rezulton në vlerën 50.36 euro/MWh.

- Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit euro/lekë për çdo muaj të vitit 2019, rezulton që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2019 të jetë 123.01 euro/lekë.

- Nisur nga elementet e përcaktuara më sipër dhe në zbatim të formulës përllogaritëse të pikës 3, të VKM-së nr. 687, datë 22 nëntor 2017, në lidhje me metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020 është 8.0532 lekë/kWh.

- Me publikimin e raportit përfundimtar vjetor të Bankës së Shqipërisë, nëse për kursin e këmbimit lekë/EUR do të rezultojnë diferenca nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike prej 8.0532 lekë/kWh, i cili do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020.

2. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019, në rast se kursi i këmbimit lekë/EUR do të rezultojnë i ndryshëm nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2020.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti